



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:040416

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05722701

C.nr.1494/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Erlinda Elezi-Tosku, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve E.H dhe B.H nga Komuna e Gjilanit, B.F dhe B.M nga Gjilani dhe A.M nga Komuna e Kamenicës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson M.H, avokate nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 7,383.84 euro, jashtë seancës, me datë 17.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve E.H dhe B.H nga Komuna e Gjilanit, B.F dhe B.M nga Gjilani dhe A.M nga Komuna e Kamenicës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, që :

Paditësit E.H, që në emër të kualifikimit me fakultet, për periudhën kohore 01.02.2021 deri më 31.01.2023, për 24 muaj, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 1,328.40 euro,

Paditësit B.H, që në emër të kualifikimit me fakultet, për periudhën kohore 01.02.2021 deri më 31.01.2023, për 24 muaj, duke llogaritur nga 52.58 euro për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 1,261.92 euro,

Paditësit B.F, që në emër të kualifikimit me fakultet, për periudhën kohore 01.02.2021 deri më 31.01.2023, për 24 muaj, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 1,328.40 euro,

Paditëses B.M, që në emër të kualifikimit me fakultet, për periudhën kohore 01.02.2021 deri më 31.01.2023, për 24 muaj, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 1,328.40 euro,

Paditësit A.M, që në emër të kualifikimit me master, për periudhën kohore 01.02.2021 deri më 31.01.2023, për 24 muaj, duke llogaritur nga 89.03 euro për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 2,136.72 euro

Të gjitha me kamatë ligjore prej 8 % nga data 23.01.2024, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës paditësve në shumën e përgjithshme prej 321.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 05.02.2024 kanë paraqitur padi, kurse me datë 13.05.2024 kanë paraqitur parashtresen për precizimin e padisë në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 7,383,84 euro euro.

Në padi kanë theksuar se të njëjtit janë të punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët (në vijim: SHFMU) "Mulla Idris Gjilani" në fshatin Velekincë Komuna e Gjilanit, në cilësinë e mësimitdhënësve, përveq paditësit B.H, që është në pozitën e sekretarit dhe vazhdojnë të jenë në të njëjtat pozita të punës me orarë të plotë të punës. Përkundër kualifikimit të tyre shkollor me fakultet dhe master, asnjëherë nuk janë kompensuar për aq sa e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënëse, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën 01.02.2021 deri më 31.01.2023, paditësi A.M, është kompensuar vetëm në shumën prej 58.32 euro, për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhen në shumën prej 147.35 euro (sipas 35 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 89.03 euro në muaj, paditësi B.H, është kompensuar vetëm në shumën prej 55.35 euro, për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhen në shumën prej 107.93 euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 52.58 euro në muaj, ndërsa, paditësit E.H, B.F dhe B.M, janë kompensuar vetëm në shumën prej 58.32 euro për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhen në shumën prej 113.67 euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro në muaj. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 260.00 euro, për përpilim të padisë dhe 61.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në

fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie punë tek e paditura.

Për paditsin E.H, (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar së paditësit me të paditurën, nr.prot.1341 e dt.01.09.2015).

Nuk është kontestuese se i njëjti ka kualifikim shkollor të nivelit bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra Gjilan (fakt i vërtetuar edhe nga certifikata ref.nr. 1020/a e dt.24.06.2015), është mësimdhënës i licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100020014 e dt.20.05.2014) dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e lëshuar në emër të paditësit nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Për paditsin B.H, (fakt i vërtetuar nga akt emërimi i punës në kohë të pacaktuar së paditësit me të paditurën, nr.prot.104/ e dt.01.04.2013).

Nuk është kontestuese se i njëjti ka kualifikim shkollor universitar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Juridik (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.637 e dt.12.01.2004), dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 399.75 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 55.35 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e lëshuar në emër të paditësit nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Për paditsin B.F, (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar së paditësit me të paditurën, nr.prot.1342 e dt.01.09.2015).

Nuk është kontestuese se i njëjti ka kualifikim shkollor të nivelit bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra Prishtinë (fakt i vërtetuar edhe nga certifikata ref.nr.1011/a e dt.11.07.2015), është mësimdhënës i licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100020021 e dt.20.05.2014) dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32 euro, sipas kërkesëpadisë).

Për paditsen B.M, (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar së paditëses me të paditurën, nr.prot.1344 e dt.01.09.2015).

Nuk është kontestuese se e njëjta ka kualifikim shkollor të nivelit bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra Gjilan (fakt i vërtetuar edhe nga certifikata ref.nr.227/a e dt.01.03.2014), është mësimdhënëse e licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100020027 e dt.20.05.2014) dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e lëshuar në emër të paditësit nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Për paditsin A.M, (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar së paditësit me të paditurën, nr.prot.172 e dt.01.09.2015).

Nuk është kontestuese se i njëjti ka kualifikim shkollor të nivelit master nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.*40 e dt.20.02.2019), është mësimdhënësi i licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100022080 e dt.13.03.2015) dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32 euro, sipas kërkesëpadiisë).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadiisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëseve pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me kualifikim master paditësi A.M është kompensuar vetëm në shumën prej 58.32 euro, për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhen në shumën prej 147.35 euro (sipas 35 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 89.03 euro në muaj, paditësi B.H, me kualifikim bachelor është kompensuar vetëm në shumën prej 55.35 euro, për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhen në shumën prej 107.93 euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 52.58 euro në muaj, ndërsa, paditësit E.H, B.F dhe B.M, janë kompensuar vetëm në shumën prej 58.32 euro për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhen në shumën prej 113.67 euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro në muaj, ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, për kualifikimin me master është dashur të paguhen në shumën prej 147.35 euro, me ç'rast i ka mbetur borxh në shumën prej 89.03 euro, kurse për kualifikimin me bachelor për paditësin Bajram Hajrullahu, me kualifikim bachelor dashur të paguhen në shumën prej 107.93 euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 52.58 euro në muaj, kurse paditësit tjerë me kualifikim bachelor është dashur të paguhen në shumën prej 113.67 euro, me ç'rast i ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro, kurse periudha e kërkuar për këtë kompensim përfshin kohën sa ka qenë në fuqi Vendimi i Qeverisë dhe nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 05.02.2024, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga muaji Shkur 2021.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
.C.nr.1494/2024, më datë 17.05.2024

Numri i lëndës: 2024:040416
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05722701

Gjyqtarja,
Kaltrinë Haliti

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.